



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 197, Datë 24.11.2017

MBI

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR. 134, DATË 24.12.2014, PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “A&A GROUP” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16, 20 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 16 dhe 104 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 4.4 të licencës së furnizimit miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 98 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 134, datë 24.12.2014, “Për licencimin e shoqërisë “A&A Group” sh.p.k, në aktivitetin e furnizimit së energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “A&A Group” sh.p.k, me shkresën nr. 663 Prot., i ERE, datë 09.10.2017, ka njoftuar ERE për ndërrimin e administratorit dhe aksionerëve të të licencuarit.
- Shoqëria “A&A Group” sh.p.k, është licencuar nga Bordi i ERE, në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike, me vendimin e Bordit nr. 134, datë 24.12.2014 dhe disponon licencën me nr. 259, Seria FK14, për një periudhë 5 vjeçare.
- Rezulton se, subjekti ka njoftuar ERE pas 8 (tetë) muajsh, për ndryshimet në shoqëri, në kundërshtim kjo me pikën 4.4 të licencës së furnizimit, ku parashikohet se licencuari duhet të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve. Shkelja e këtij detyrimi nga i licencuari sjell si pasojë heqjen e licencës nga ERE.
- Nëse i Licencuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksioneri/ortaku qc kontrollon interesin ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, Licenca bëhet nul (e pavlefshme) ose anulohet dhe pasuesi i të Licensuarit do të aplikojë për një licencë të re në përputhje me procedurat e ERE-s për dhënie licence.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 134, datë 24.12.2014, të Bordit të ERE, “Për licencimin e shoqërisë “A&A Group” sh.p.k në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Licenca me nr. 259, Seria FK14 e shoqërisë “A&A Group” sh.p.k, bëhet e pavlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kërkesa për rishikimin e këtij vendimi, mund të bëhet në ERE brenda 7 ditëve kalendarike.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI